



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

Pml.nr.215/2021

### NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Valdete Daka, kryetare, Agim Maliqi dhe Mejreme Memaj, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit Sh.A., për shkak të veprave penale: marrja e ryshfetit nga neni 428 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) dhe moslajmërimi i veprave penale apo i kryerësve të tyre nga neni 386 par.2 lidhur me par.1 nënpar.1.6 dhe 1.9 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitura nga mbrojtësi i të dënuarit kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.66/2020 të datës 13.11.2020 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.476/2020 të datës 10.03.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më 15 korrik 2021, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

Me miratimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit Sh.A., ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.66/2020 të datës 13.11.2020 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.476/2020 të datës 10.03.2021 dhe bazuar në nenin 364 par.1 nënpar.1.3 të KPPK-së, i dënuari,

Lirohet nga akuza

Se me datë 02.09.2017, në cilësi të personit zyrtar komandantit të Stacionit Policor në Novobërdë, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror, ka pranuar dhuratë-drunjtë për

ngrohje në sasi rreth 3-4 m<sup>3</sup>, për zbulimin e vjedhjes së pyllit në pronësi të N.M. nga Gj., ashtu që I.D. i kërkon një traktor me dru N.M. për të pandehurin Sh.A., me arsyetim se i njëjti e kishte zbuluar vjedhjen e malit, N.M. përmes I.M. dhe I.D. ia dërgon të pandehurit sasinë e drunjtëve dhe përmes telefonit N., e njofton të pandehurin duke i thënë “përshëndetje shoq punën ta kryta drunjtë ia dhashë I., me ti pru” dhe pastaj i pandehuri i falënderohet,

- me çka kishte për të kryer veprën penale marrja e ryshfetit nga neni 428 par.1 të KPRK-së.

Gjatë periudhës kohore 22.07.2017 deri me 23.07.2017, duke qenë zyrtar policor, përmes telefonit komunikon me të pandehurin I.D. dhe pasi që nga i njëjti mëson se pa leje valide është duke poseduar armë të zjarrit dhe se të njëjtën do ta përdorë në dasmë e cila armë gjatë bastisjes është sekuestruar nga i pandehuri I.D., po ashtu nga i pandehuri mëson se i njëjti është duke e mbajtur në bashkësi jashtëmartesore personin nën 16 vjeçare dhe nuk ndërmerr veprime zyrtare por i jep udhëzime duke i thënë “të bëj kujdes deri në muajin gusht pasi e njëjta i mbush 16 vjet” edhe pse si person zyrtar- komandant i Stacionit Policor në Novobërdë mëson për këto dy vepra penale të njëjtat nuk i lajmëron dhe të cilat vepra janë të dënueshme sipas KPRK-së me më tepër se tri vjet burgim,

- me çka kishte për të kryer veprën penale moslajmërimi i veprave penale apo i kryerësve nga neni 386 par.2 lidhur me par.1 nënpar.1.6 dhe 1.9 të KPRK-së.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës, kurse i dëmtuari N.M., për realizimin e kërkesës pasuror juridike udhëzohet në kontest civil.

## A r s y e t i m

### **Vendimi i Gjykatës Themelore**

Gjykata Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.66/2020 e datës 13.11.2020, të dënuarin Sh.A. e ka shpallur fajtor për veprat penale: marrja e ryshfetit nga neni 428 par.1 të KPRK-së dhe moslajmërimi i veprave penale apo i kryerësve të tyre nga neni 386 par.2 lidhur me par.1 nënpar.1.6 dhe 1.9 të KPRK-së dhe e ka gjykuar me dënim burgimi me kusht në kohëzgjatje prej 180 (njëqindetëdhjetë) ditë dhe i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën kohore prej 1 (një) viti, nuk kryen vepër tjetër

penale dhe me dënim me gjobë në lartësi prej 1500 (njëmijepesëqind) €. I dënuari është obliguar në pagesën e paushallit gjyqësor në shumë prej 50 €, si dhe shumë prej 50 € në fondin për kompensimin e viktimave të krimit, kurse pala e dëmtuar nuk ka paraqitur kërkesë pasurore-juridike.

### **Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës**

Gjykata e Apelit e Kosovës me aktgjykimin PAKR.nr.476/2020 e datës 10.03.2021, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

### **Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë**

Kundër këtyre aktgjytimeve kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit, av. Y.H. nga Gj., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të anuloj aktgjykimet e kundërshtuara dhe lëndën ta kthejë në rigjykim.

### **Mendimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit**

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.139/2021 e datës 22.06.2021, ka propozuar që kërkesa e mbrojtëses së të dënuarit të refuzohet si e pabazuar.

### **Pretendimet e paraqitura në kërkesë**

Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit thekson se në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ekzistojnë kundërthënie të theksuara në hyrjen e aktgjykimit pasi që si datë e përpilimit të aktgjykimit është shënuar data 19.11.2019, kurse si datë e marrjes së aktgjykimit është shënuar data 19.11.2020, përtej kësaj një gabim i tillë konsiderohet edhe jashtë logjikës pasi që nuk është e mundur që aktgjykimi të merret me datë 13.11.2020, kurse përpilimi i tij të bëhet një vit më parë përkatësisht me datë 19.11.2019, ndonëse mund të jetë edhe gabim teknik.

Pretendohet se dispozita e nenit 361 par.1 të KPPK-së ka përcaktuar se aktgjykimi duhet të bazohet në faktet dhe provat e procedura në shqyrtimin gjyqësor, kurse duke u referuar në aktgjykimet e kundërshtuara del se aktgjykimet nuk bazohen në provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor. Aktgjykimet e kundërshtuar nuk kanë paraqitur në mënyrë të qartë dhe të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyes i kanë konsideruar të vërtetuara apo të pavërtetuara dhe veçanërisht nuk i kanë vlerësuar provat kundërthënëse, me ç'rast aktgjykimet janë marrë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Më tutje në kërkesë pretendohet në shkeljen e ligjit penal dhe theksohet fakti se në asnjë fazë të procedurës penale dhe me asnjë provë nuk është vërtetuar se i dënuari ka kërkuar apo ka pranuar dhuratë nga i dëmtuari N.M., pasi që drunjtë i ka kontraktuar me dëshmitarin I.M. dhe se ky dëshmitar së bashku me dëshmitarin tjetër I.D. faktikisht drunjtë i kanë marrë nga i dëmtuari N.M. për ti dërguar tek i dënuari, mirëpo të cilat pastaj ia shesin të dënuarit. Në këtë rast nuk është kontestues fakti se i dënuari kishte marrë pjesë në zbulimin e rastit të vjedhjes së malit të N.M., por fakti i angazhimit të tij nuk ka vërtetuar se për këtë arsye të ketë kërkuar apo pranuar dhuratë, por ka qenë i keqpërdorur nga ana e dëshmitarëve I.D. dhe I.M. Kurse konstatimi i gjykatës së shkallës së parë në aktgjykimin e saj se "...gjykata është e bindur se drunjtë nuk janë paguar...", është arsyetim jo bindës dhe i pambështetur në prova dhe fakte konkrete.

Pretendime të ngjashme janë theksuar edhe për veprën penale të përshkruar në dispozitivin e dytë të aktgjyimit të gjykatës së shkallës së parë dhe atë nga fakti se po të vlerësoheshin këto biseda më me vëmendje nga gjykata e shkallës së parë me siguri se do të binte konkludime tjera përkitazi me këtë veprës penale. Theksohet fakti se fillimisht nuk ishte kontestues se I.D. posedonte pushkën e gjuetisë me leje përkatëse të skaduar dhe të cilën nuk e ka përdorur, për më tepër, nga rrjedha e bisedës del se biseda ishte për përdorimin e saj përkatësisht për të shtënë në dasmë dhe jo për të poseduar atë. Në mënyrë të ngjashme ishte zhvilluar biseda edhe përkitazi me moshën e personit me të cilën I.D. po donte të martohet dhe i dënuari vetëm e kishte këshilluar që të njoftonte prindërit e vajzës dhe pastaj të merrte pëlqimin e tyre për martesë.

## **Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës**

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

- kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e bazuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimi i mbrojtësit të të dënuarit, është i bazuar, ngase aktgjykimet e kundërshtuara janë marrë në shkelje të ligjit penal nga neni 385 par.1 nënpar.1.4 të KPPK-së, pasi që nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprat penale për të cilat është akuzuar.

Gjykata e shkallës së parë të pandehurin e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale marrja e ryshfetit nga neni 428 par.1 të KPRK-së, duke përshkruar në dispozitivin e aktgjykimit të saj se kishte pranuar dhuratë-drunjë për ngrohje në sasi rreth 3-4 m<sup>3</sup>, për zbulimin e vjedhjes së pyllit në pronësi të N.M. nga Gj. Mirëpo, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës jo vetëm nga përshkrimi i theksuar me lartë, por as nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, rezulton se në rastin konkret në veprimet e të pandehurit nuk janë realizuar të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale në fjalë dhe i cili konkludim rezulton nga analiza e dispozitës së nenit 428 par.1 të KPRK-së e cila ka përcaktuar se: *“Personi zyrtar i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, kërkon ose pranon ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër për vete apo personin tjetër, ose që pranon ofertën apo premtimin për dhuratë apo përfitim të tillë, në mënyrë që personi zyrtar të veprojë ose të mos veprojë në pajtim me detyrën e tij zyrtare”*.

Përshkrimin e veprës penale duhet interpretuar në tërësinë e saj përkatësisht në të gjitha elementet e saj dhe jo në mënyrë fragmentare, andaj, fillimisht është e rëndësishme të përcaktohen elementet e kësaj vepre penale dhe më pas të konstatohet se a janë përmbushur apo jo elementet e kërkuara dhe atë: së pari duhet të përcaktohet fakti se a është i pandehuri person zyrtar, a ka kërkuar përkatësisht pranuar dhuratë apo përfitim tjetër për vete apo për personin tjetër dhe së fundmi se personi zyrtar a veproj apo nuk veproj në pajtim me detyrën e tij zyrtare.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës sa i përket kësaj vepre penale në rastin konkret është përmbushur vetëm elementi fillestar pasi që në rastin konkret bëhet fjalë për person zyrtar, kurse nuk janë përmbushur në mënyrë kumulative elementet tjera të veprës penale me

qëllim të vepra penale të ekzistojë. Së pari nuk është vërtetuar fakti se i pandehuri kishte pranuar dhuratën përkatësisht sasinë e drunjtëve për faktin se kishte zbuluar vjedhjen e pyllit të N.M. Nga provat e administruara del se drunjtë ishin dërguar në oborrin e shtëpisë së të pandehurit nga ana e I.M dhe I.D., mirëpo bazuar në dëshminë e këtyre dëshmitarëve dhe të dëshmitarit N.M. rrjedh se për drunjtë e dërguara tek i pandehuri ishte paguar shuma prej 150€ nga ana e bashkëshortes së të pandehurit. Në rastin konkret nuk ka asnjë provë me të cilën është vërtetuar fakti se i pandehuri kishte kërkuar përkatësisht pranuar drunjtë nga ana e dëshmitarit N.M. Për më tepër, nuk është realizuar edhe elementi tjetër i veprës penale se cila ishte mënyra e kryerjes së veprës penale, pra a ishte kryer veprimi apo mos veprimi i të pandehurit në pajtim me detyrën e tij zyrtare dhe gjithë këtë duke e ndërlidhur me faktin se i pandehuri në cilësi të personit zyrtar nuk kishte marrë pjesë në procedurën hetimore për zbulimin e vjedhjes në pronën e N.M.

Në këtë mënyrë në rastin konkret, bazuar në shkresat e lëndës del se nuk është vërtetuar se në veprimet e të pandehurit janë realizuar të gjitha tiparet e kësaj vepre penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor dhe është dënuar.

Duke vlerësuar pretendimet e theksuara në kërkesë, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson faktin se në veprimet e të dënuarit nuk formësohen elementet e veprës penale dhe moslajmërimi i veprave penale apo i kryerësve të tyre nga neni 386 par.2 lidhur me par.1 nënpar.1.6 dhe 1.9 të KPRK-së dhe tek i cili konkludim ka arritur duke analizuar dispozitën e nenit 386 par.2 të KPRK-së e cila ka përcaktuar se: *“Personi zyrtar apo personi përgjegjës i cili nuk e lajmëron veprën penale të cilën e ka zbuluar gjatë ushtrimit të detyrës së tij”*.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës në rastin konkret është përmbushur vetëm elementi fillestar pasi që në rastin konkret bëhet fjalë për person zyrtar, kurse nuk janë përmbushur në mënyrë kumulative elementet tjera të veprës penale se nuk ka lajmëruar veprën penale dhe të cilën e ka zbuluar gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare.

Bazuar në shkresat e lëndës është i qartë fakti se vepra penale nuk është zbuluar gjatë detyrës zyrtare, mirëpo zbulimi i saj është bërë gjatë bisedave telefonike mes të të pandehurit dhe dëshmitarit I.D., dhe të cilat nuk ndërlidheshin fare me detyrën zyrtare që e ushtronte i pandehuri, ashtu që në veprimet e të pandehurit nuk janë përmbushur elementet e veprës penale për të cilën i pandehuri ishte shpallur fajtor dhe ishte dënuar.

Bazuar në dispozitën e nenit 112 par.3 të KPPK-së, gjykata ka udhëzuar të dëmtuarin që realizimin e kërkesës pasurore –juridike mund ta realizoj në kontest civil, kurse konform nenit 103 par.1 të KPPK-ës, shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve të kësaj Gjykate.

Në rastin konkret aktgjykimet e gjykatave të dy instancave më të ulëta janë përfshirë në shkelje të ligjit penal kështu që pretendimi i mbrojtësit të të dënuarit i paraqitur në kërkesë ishte i bazuar, andaj në kuptim të nenit 438 par.1 nënpar.1.1 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.215/2021, më 15 korrik 2021

B.profesional,  
Bujar Balaj

Kryetarja e kolegjit,  
Valdete Daka